16/01/2024

Doli në qarkullim botimi: “TIPIKOJA E SHËRBESAVE TË PËRDITSHME KISHTARE 2024”



Tipikoja e shërbesave të përditshme kishtare është udhëzues për kleriket dhe psaltët, që ndihmon në kryerjen e saktë dhe të njëtrajtshme të shërbesave adhuruese ditore përgjatë vitit litrugjik kishtar.

Hartimi i kësaj Tipikoje në shqip u bazua në librin Κυριακοδρόμιον και Μηνολόγιον του έτους 2024, duke u përshtatur me praktikën liturgjike të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe duke dhënë citime dhe referime ndihmëse nga librat liturgjikë në shqip: “Libri i të Kremteve të Mëdha”, “Triodi”, “Pesëdhjetorja”, “Kremtore”, Boston, Mass., 1911-1952; “Libri i Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse”, “Java e Madhe e Shenjtë”, “Tetëtingullshi Ngjallësor”, “Uratore e vogël”, “Kalendari Orthodhoks”, Tiranë 1994-2024.

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë